

UDC 343.848

Armend Asllani, MA⁵⁸

TRETMANI I PERSONAVE TË DËNUAR

ТРЕТМАНОТ НА ОСУДЕНИТЕ ЛИЦА

THE TREATMENT OF CONVICTED PERSONS

Abstract

Resocialization and the social adaptation are the main purposes of imprisonment sentence. In order these purposes have full realization and success, should be used more mechanisms and rehabilitation activities in the penalty-penitentiary institutions, where this method of application should be included, since the moment of conviction of the person placing the penitentiary institutions until the release from these institutions (prisons).

The term “treatment”, represent a complex conglomerate of methods, approaches, procedure actions organized by the convicted person, before during his sentences and after release from the penitentiary with the intention to adapt a more complete and functional values offered by the society.

This paper includes in itself a concise explanation of the term, understanding and most important principles of treatment of convicted persons. In particular through analysis and synthesis we notified closer to the particular forms of treatment of convicted persons based on national positive legislation and international legislation, different recommendations regarding these very important particular forms of resocialization.

⁵⁸ Master of Science in Criminal Law, State University of Tetova, Business Administration Faculty
e-mail:asllaniarmend@gmail.com

Keywords: treatment, resocialization, recommendation

Abstrakt

Risocializimi dhe adaptimi social janë qëllimet kryesore të dënimit me burgim. Që të munden, këto qëllime të kenë realizim dhe sukses të plotë, duhet të përdoren shumë mekanizma dhe veprime riedukuese në institucionet ndëshkuese-penitenciare, ku kjo mënyrë e aplikimit duhet të përfshihet, që nga momenti i dënimit të personit, vendosjen në institucionet penitenciare e deri në momentin e daljes nga këto institucione (burgje).

Nocioni “*tretman*”, paraqet një konglomerat kompleks të metodave, mënyrave, procedurave të organizuara të veprimit me personin e dënuar para, gjatë vuajtjes së dënimit dhe pas daljes nga institucionet ndëshkuese me qëllim të adaptimit sa më të plotë dhe funksional me vlerat që i ofron shoqëria.

Ky punim përfshinë një shpjegim konciz të termit, kuptimit dhe parimeve më të rëndësishme të tretmanit të personave të dënuar. Në veçanti, nëpërmjet analizës dhe sintezës do të njoftohemi më afër me format e veçanta të tretmanit të personave të dënuar bazuar në legjislacionin pozitiv vendas dhe ndërkombëtar, rekomandimeve të ndryshme lidhur me këto forma mjaft të rëndësishme të risocializimit.

Fjalët kyçe: tretman, risocializim, rekomandim

1. Nocioni dhe kuptimi i tretmanit të personave të dënuar

Me nocionin *tretman*, nënkuptohet përmbledhja e procedurave të organizuara sistematike dhe dinamike, që ndërmerren nga ana e ekspertëve penitenciar ndaj personave të dënuar, që të arrihet risocializimi i tyre ose adaptimi social, respektivisht për realizimin e

karakteristikave strukturale dhe dinamike të personalitetit, që nuk do të lajmërohen si determinanta individuale të kriminalitetit⁵⁹.

Me nocionin *tretman*, nënkuptojmë sistemin e caktuar individual dinamik të metodave, masave dhe procedurave ndaj personit të dënuar në entin ndëshkues penal gjatë kohës së kryerjes së dënimit me burgim dhe në periudhën (fazën) postinstitucionale, për shkak të drejtimit, zhvillimit dhe realizimit të veçorive pozitive dhe aftësive të personit të dënuar për risocializimin e tij ose adaptimin social në shoqëri, pas mbarimit të dënimit⁶⁰.

Qëllimi i dënimit me burgim, më herët ishte që të burgosurit në mënyrë izoluese të paguajnë për atë që kanë bërë dhe në këtë mënyrë tentohej që të parandalohet kriminaliteti në shoqëri. Mirëpo, në sistemet penitenciare moderne u ndryshua edhe qëllimi i dënimit, ku përpos parandalimit të kriminalitetit bëhej përpjekje që personat e dënuar të vetëdijesohen, t'u kthehen personalitetit në nivel të duhur dhe me këto veprime të largojnë personat e dënuar nga izolimi shkatërrues dhe me këtë të munden, që përsëri në njëfarë mënyre të rilindin dhe t'u adaptohen sfidave të përditshme që hasen në shoqëri. Ndaj edhe në institucionet penitenciare nga qëllimet e ndryshme dënuese, përdoren metoda të tretmaneve të ndryshme si pedagogjike, medicinale, sociale dhe të natyrave të ndryshme, vetëm me një qëllim që të ndikojnë pozitivisht në personalitetin e tyre, karakterin etj., dhe në këtë mënyrë të arrihet risocializimi si qëllim i tretmanit institucional dhe postpenal.

D.m.th ashtu siç potencuam më lartë se nocioni tretman nga kuptimi më i ngushtë ka arritjen e qëllimeve të risocializimit dhe adaptimit social, apo më ndryshe kemi të bëjmë me tretmanin penitenciar riedukues.

Megjithatë, ekziston edhe një kuptim më i gjerë i tretmanit penitenciar ku risocializimi dhe adaptimi social nuk është e thënë që

⁵⁹ Sulejmanov. Z, *Penologjia*, Skopje, 1999, f. 413.

⁶⁰ Ministria e drejtësisë- Drejtoria për ekzekutimin e sanksioneve penale, Udhëzimet për llojet dhe mënyrën e tretmanit të personave të dënuar (Gaz.Zyrtare e R.M-së nr.123/2007), neni 3.

gjithmonë të jenë, si qëllime përfundimtare të tretmanit penitenciar⁶¹. Këtu kemi kuptimin e përfshirjes së tretmanit në të gjitha fazat, si në fazën e tretmanit institucional ashtu edhe në atë postpenal.

Tretmani si sistem i metodave, masave dhe procedurave drejtuar ndaj risocializimit të personit të dënuar, nënkupton metodat e natyrës objektive dhe subjektive. Metodatat e natyrës objektive në Penologji shpesh emërohen si ndihmë, ndërsa metodatat e natyrës subjektive si riintegrim të personit të dënuar⁶².

2. Parimet elementare të tretmanit të personave të dënuar

Parimet elementare të tretmanit të personave të dënuar janë:

- a) Parimi i njohjes së secilit person të dënuar;
- b) Parimi i respektimit dhe besimit ndaj personit të dënuar;
- c) Parimi i angazhimit të pandërprerë të personit të dënuar;
- ç) Parimi i inkuadrimit (kyçjes) aktiv dhe vullnetar të personit të dënuar në tretmanin personal;
- d) Parimi i zhvillimit të vetëdijes shoqërore dhe individualitetit të personit të dënuar;
- dh) Parimi i sistematizimit dhe klasifikimit në realizimin e tretmanit;

a) Parimi i njohjes së secilit person të dënuar

Esenca e këtij parimi qëndron në njohjen thelbësore të secilit person të dënuar, nga ana e shërbimeve riedukuese të institucioneve penitenciare, e cila njohje asocon në cilësitë bio-psikosociale, karakterin dhe motivet e secilit person të dënuar, që kanë pasur ndikim relevant në sjelljet e tyre delikvente dhe jo të pranuar shoqërore dhe që kanë dërguar deri tek shkeljet e patoleruara ligjore. Ky observim realizohet nga personat e autorizuar penitenciar duke u mbështetur në dokumentacionet e organeve gjyqësore, në entet pranuese,

⁶¹ Sulejmanov. Z, *Penologjia*, f. 413.

⁶² Milutinović. M, *Penologjia*, Savremena administracija, Beograd, 1992, f. 96.

informatat e ndryshme në teren, mandej nga bisedimet, analizat e ndryshme me personat e dënuar gjatë vuajtjes së dënimit në institucionet penitenciare etj. Vetëm në këtë mënyrë të njohjes esenciale, tretmani i realizuar ndaj tyre mund të ketë sukses të mëtutjeshëm⁶³.

b) Parimi i respektimit dhe besimit ndaj të dënuarit

Sipas këtij parimi duhet që personave të dënuar të mos u mohohen vlerat elementare shoqërore, e që janë mirëbesimi dhe respektimi. Edhe pse ka shumë kontradikta në pikëpamje të këtyre vlerave humane, prapëseprapë është aplikuar ky parim nëpër institucionet penitenciare, për një arsye se tretmanët dhe shumë forma tjera të programeve riedukuese institucionale dhe jashtë institucionale duke ndikuar në krenarinë e tyre njerëzore dhe respektimin e mirëfilltë të këtyre vlerave parimore, do të kenë edhe realizim më të suksesshëm konform planit dhe qëllimit risocializues⁶⁴.

c) Parimi i angazhimit të pandërprerë të personit të dënuar

Sipas këtij parimi, duhet që personat e dënuar të jenë vazhdimisht në mënyrë aktive të angazhuar gjatë vuajtjes së dënimit. Duhet, që gjithnjë të kenë në shfrytëzim racional tretmanin e aktiviteteve dhe në këtë mënyrë me angazhim të pandërprerë të kohës që kanë në dispozicion të harrojnë të kaluarën e dhimbshme dhe të përqendrohen, gjithnjë e më shumë në realizimin sa më të suksesshëm të detyrave dhe aktiviteteve që i parashtrajnë personeli riedukues⁶⁵.

Në këtë mënyrë personat e dënuar bëhen me ego më të fortë, me vetëdije dhe normalisht me karakter më të lartë që rezultojnë edhe me efikasitet më të dukshëm të tretmanëve institucional riedukues⁶⁶.

⁶³ Sulejmanov. Z, *Penologjia*, Skopje, 1999, f. 415.

⁶⁴ Ibid, f. 416.

⁶⁵ Ibid, f. 417.

⁶⁶ Ibid, f. 417.

ç) Parimi i inkuadrimin aktiv dhe vullnetar i personit të dënuar në tretmanin personal

Në institucionet penitenciare, i gjithë tretmani riedukues për personat e dënuar ofron dituri, punë produktive dhe shumë shprehje pozitive, e që natyrisht se ndikon në formimin e vetëdijes personale tek të gjithë personat e dënuar dhe me këtë edhe drejt rrugës së realizimit të suksesshëm të risocializimit të tyre. Personat e dënuar në mënyrë aktive dhe vullnetare i qasen procesit të tretmanit riedukues, atëherë kur të gjithë mjetet dhe format që aplikohen në tretmanin riedukues janë në favor dhe në interes të tyre duke forcuar bindjen, karakterin me gjithë vetëdijen qenësore dhe shoqërore.

d) Parimi i zhvillimit të vetëdijes shoqërore dhe individualitetit të personit të dënuar

Që tretmani të ketë produktivitet tek personat e dënuar, duhet që të jetë i drejtuar kah zhvillimi i vetëdijes shoqërore dhe zhvillimit të individualitetit të personit të dënuar. Me zhvillimin dhe forcimin e këtyre pikëpamjeve dhe vlerave shoqërore, personat e dënuar në fjalë do të kenë një integrim më të mirë në shoqëri, duke rikthyer përsëri personalitetin e humbur me rastin e kryerjes së veprave penale. Nëse personit të dënuar i pengohet në procesin e individualizimit, atëherë në mënyrë të palejuar depërtohet në brendësinë e tij, në psikën që në vete fsheh kuptimin personal për jetë⁶⁷. Me pengimin e këtij procesi shkatërrohet gjithçka që është personale tek personi, duke shkaktuar çrregullime neurotike, somatike, neuroza, psikoza etj. Me sjelljen e personave të dënuar në këtë gjendje, jo vetëm se nuk realizohet procesi i tretmanit, por edhe degradohet personaliteti i skajshëm i tyre. Me këtë rast kur kemi konfrontim të personit me individualitetin e tij, nuk mundet që të ketë integrim me vlerat shoqërore dhe normalisht bie vetëdija shoqërore. Personat në fjalë nuk guxojnë që të jenë vendimmarrës autokton, nuk munden të marrin përmby supë ngarkesa dhe përgjegjësi, me një fjalë gjithçka që

⁶⁷ Ibid, f. 420.

është individuale tek këto shkatërrohen dhe vlerat shoqërore dhe vetëdija e tyre morale nuk do të kenë më rezultatin e duhur⁶⁸.

dh) Parimi i sistematizimit dhe klasifikimit në realizimin e tretmanit

Gjatë procesit të tretmanit, zgjedhja e masave riedukuese, varet nga nevoja e secilit person. Me caktimin e një plani konkret të aplikimit, ku do të jenë të caktuara të gjitha elementet e nevojshme, tretmani do të jetë më efikas. Në realizimin e tretmanit duhet kushtuar rëndësi të veçantë këtij parimi të sistematizimit dhe klasifikimit, ku sistematizimi nënkupton që nuk do të jetë e harruar, apo lënë mbas dore asnjë pikëpamje e veprimit, që është me rëndësi të veçantë të suksesit të tij përfundimtar, kurse klasifikimi gjatë tretmanit, çdoherë në fillim nis drejt realizimit të ndryshimeve më të lehta të personalitetit dhe mandej më vonë dëpërtohet në nevojat më të thella të tretmanit dhe kështu ndryshohen ato cilësi psiko-sociale që vështirësojnë apo pengojnë realizimin riedukues⁶⁹.

3.Format e veçanta të tretmanit të personave të dënuar

Në literaturën penologjike rëndësi të veçantë në riedukimin, risocializimin dhe adaptimin social kanë format e tretmanit të personave të dënuar.

3.1. Puna si formë e tretmanit

Karakteristika bazike e sistemeve penitenciare bashkëkohore është raporti i ndryshuar ndaj punës së personave të dënuar, ku sot aplikohet si formë elementare e tretmanit në risocializimin e tyre⁷⁰. Punës së personave të dënuar si formë tretmani, kryesisht i qasemi

⁶⁸ Ibid, f. 420.

⁶⁹ Ibid, f. 422.

⁷⁰ Arnaudovski. L, *Penologjia, nauka za izvršuvawe na krivi~nite sankcii*, Praven Fakultet, Skopje, 1988, f. 245.

nga dy aspekte: e para, me anë të punës krijohen shprehitë e punës tek personi i dënuar, krijohet një bindje e thellë, se me anë të punës mundet të sigurohet një jetë e lumtur, dhe e ndershme dhe e dyta, përmes punës personi i dënuar aftësohet, fiton kualifikime të ndryshme profesionale dhe mes tjerash mund të sigurojë një jetë më të sigurt sociale dhe materiale⁷¹.

Puna paraqet atë veprimtari sociale nga realizimi i së cilës varet para se gjithash ekzistenca njerëzore, mandej kënaqja e të gjitha nevojave të tjera për realizimin dhe zhvillimin e tij si qenie gjenerike⁷².

Sa i përket punës në sistemet penitenciare, mund të themi se puna e personave të burgosur paraqet faktorin primar për edukimin dhe riedukimin e tyre⁷³.

Puna në burg konsiderohet si element pozitiv i regjimit të burgut dhe asnjëherë nuk duhet të shfrytëzohet si dënim⁷⁴. Nga personat e burgosur, kërkohet që të punojnë atë lloj të punës që është në pajtueshmëri me aftësitë e tyre fizike dhe psikike⁷⁵. Administrata e burgut, duhet të bëjë përpjekje për të siguruar punë të mjaftueshme dhe të dobishme për të burgosurit⁷⁶. Organizimi dhe metodat e punës në institucion, duhet të jenë sa më të përafërta me punën jashtë institucionit, në mënyrë që të burgosurit të përgatiten për kushtet e punës në jetën normale⁷⁷. Administrata e burgut, punën për të burgosurit e siguron qoftë vetë qoftë në bashkëpunim me sipërmarrës, brenda dhe jashtë burgut dhe në të gjitha rastet, të burgosurit duhet

⁷¹ Ibid, f. 245.

⁷² Sulejmanov. Z, *Penologija*, Skopje, 1999, f. 549.

⁷³ Ibid, f. 551.

⁷⁴ Recommendation No.R (87)3 of the Committee of Ministers to Member States on the European Prison Rules (Adopted by the Committee of Ministers on 12 February 1987 at the 404 th meeting of the Ministers' Deputies). (<http://wcd.coe.int/com.instranet.InstraServlet?command=com.instranet.CmdBlobGet&InstranetImage=1977676&SecMode=1&DocId=692778&Usage=2>) paragrafi 71. (accessed 02.05.2013).

⁷⁵ Ibid, paragrafi 71, pika 2.

⁷⁶ Ibid, paragr.71, pika 3.

⁷⁷ Ibid, paragr.72, pika 1.

të fitojnë kompensim adekuat për punën që kryejnë.⁷⁸ Të burgosurit duhet të kenë mbrojtje adekuate shëndetësore në punë dhe kjo nuk duhet të jetë më e dobët nga gjendja shëndetësore e të punësuarve jashtë burgut⁷⁹. Në raste të lëndimeve në vendet e punës apo në rast të ndonjë sëmundjeje profesionale, është e nevojshme të sigurohet dëmshpërblimi, sipas kushteve të cilat nuk janë më pak të volitshme nga ato që me ligjin e vendit zbatohen për të punësuarit jashtë burgut⁸⁰. Të burgosurit kanë më së paku, një ditë pushim në javë dhe kohë të mjaftueshme për arsimim dhe aktivitete tjera, të cilët janë pjesë e tretmanit të tyre⁸¹.

Orari i plotë i punës së personave të dënuar, është 40 orë në javë⁸². Me përjashtim orari i plotë i punës i personave të dënuar, mund të zgjasë edhe më shumë se 40 orë në javë, por jo më tepër se plus 10 orë në javë. Orari i punës më tepër se 40 orë gjatë javës mund të zgjasë, për aq kohë sa të mënjanoen rreziqet, përkatësisht të pengohen pasojat e dëmshme⁸³.

Një përparësi tjetër e personave të dënuar, që u garantohet edhe me ligj është sigurimi invalidor për rastet e fatkeqësive në punë, apo në rast të ndonjë sëmundjeje profesionale⁸⁴.

3.2. Arsimiti dhe edukimi socialo-etikë

Arsimimi si formë e tretmanit të personave të dënuar, ka një rëndësi mjaft të madhe në riedukimin dhe riintegrimin e personave të dënuar. Arsimiti paraqitet si një ndër elementet kyç, drejt realizimit të qëllimeve të riedukimit dhe risocializimit.

⁷⁸ Ibid, paragr.73.

⁷⁹ Ibid, paragr.74.

⁸⁰ Ibid, paragr. 74, pika 2.

⁸¹ Ibid, paragr.75, pika 2.

⁸² Ligji për ekzekutimin e sanksioneve, Gazeta zyrtare e R.M nr.2/2006, neni 115, paragrafi 1.

⁸³ Osmani. A, *Komentari i ligjit për ekzekutimin e sanksioneve*, Shkup, 2013, f. 137.

⁸⁴ Ligji për ekzekutimin e sanksioneve, Gazeta zyrtare e R.M nr.2/2006, neni 122, paragrafi 2.

Nga faktet e njohura dhe të vërtetuara se personat e dënuar veprat penale, krimet apo sjelljet jo të pranuar në shoqëri, i bëjnë nga niveli i ulët i arsimimit, mospërgatitjes profesionale, primitivizimit, mosnjohjes së rrjedhave elementare shoqërore, arsimimi luan një ndikim të madh në mënjanimin e këtyre sjelljeve kriminele të personave të dënuar⁸⁵. Në shumë vende të botës, nëpër entet e tyre ndëshkuese, po ashtu edhe në vendin tonë, arsimimi paraqet një parametër, apo komponentë obligativ në aplikimin e formave të trajtimeve riedukuese. Me vet faktin se arsimimi luan një rol të madh në ngritjen e shkallës arsimore nëpër institucionet ndëshkuese duke mënjeluar sjelljet delikvente, ndikimin në shqisat intelektuale shoqërore dhe me aftësimin profesional të tyre, personat e dënuar përgatiten dhe janë më të aftë në jetën në liri, ku me arsimimin dhe aftësimin e tyre profesional të fituar, ato do të mundën të kryejnë, apo të japin kontributin e tyre nëpër institucione të ndryshme.

Aq sa të jetë praktike, arsimimi i të burgosurve duhet që të integrohet me sistemin arsimor të vendit në mënyrë që pas lirim të tyre, ata të mund të vazhdojnë arsimimin pa vështirësi, prandaj e gjithë kjo organizohet (zhvillohet) nën vëzhgimin e institucioneve të jashtme arsimore⁸⁶. Secili institucion duhet që të posedojë bibliotekë, e cila do të jetë në dispozicion për të gjithë të burgosurit, e pajisur me një spektër të gjerë librash për argëtim dhe literaturë shkencore, ku të burgosurit duhet të inspirohen sa më shumë për shfrytëzimin e tyre⁸⁷.

Të gjithë të dënuarit duhet të arsimohen dhe kjo duhet të realizohet nëpërmjet klasave mësimore, edukimit profesional, aktiviteteve kulturore-krijuese, edukimit fizik dhe shërbimit bibliotekar⁸⁸. Edukimi në burg duhet të ketë si qëllim, zhvillimin e personit

⁸⁵ Halili. R, *Penologjia,shkenca mbi ekzekutimin e sanksioneve penale*, Prishtinë, 2005, f. 193,194.

⁸⁶ Ibid, paragr. 81.

⁸⁷ Ibid, paragr.82.

⁸⁸ Recommendation No.R(89)12 of the Committee of Ministers member states on education in prison (Adopted by the Committee of Ministers on 13 October 1989 at the 429 th meeting of the Ministers' Deputies).

në tërësi duke marrë parasysh kontekstin e tij shoqëror, ekonomik dhe kulturor⁸⁹. Të gjithë të punësuarit në administratën e institucionit ndëshkues, duhet ta mirëmbajnë dhe lehtësojnë arsimimin sa më shumë të jetë e mundshme⁹⁰. Të burgosurit duhet të kenë qasje të lirë në biblioteka të paktën një herë në javë⁹¹. Tek të burgosurit duhet vazhdimisht të shprehet dhe nxitet edukimi fizik dhe sporti⁹². Duhet, që t'iu mundësohet personave të dënuar të vazhdojnë me arsimimin e tyre edhe pas daljes nga institucionet ndëshkuese-korrektuese⁹³.

Personave të dënuar, pas përfundimit të llojit adekuat dhe shkallës së arsimimit, u jepet dëftesë dhe në këtë dëftesë nuk guxon të shihet, se arsimi dhe edukimi është marrë pikërisht në institucionin përkatës ndëshkues⁹⁴. Institucionet mund të organizojnë edhe forma të veçanta për aftësim profesional të personave të dënuar në formë të kurseve, seminareve dhe llojeve tjera të aftësimit profesional me punë praktike, në pajtim me dispozitat e përgjithshme për aftësim profesional⁹⁵. Kjo formë e tretmanit është e paraparë si obligative sipas legjislacionit të vendit tonë.

Edukimi socialo-etikë-Kuptimi i tretmanit, siç kemi potencuar edhe më herët ka për qëllim që të ndikojë rrënjësisht tek personat e dënuar, në personalitetin, në përmirësimin e sjelljeve të tyre, karakterin, me një fjalë në qëndrimin, që të përmirësojnë bindjet e tyre që kanë qenë negative dhe në kundërshtim me sistemin aktual

<https://wcd.coe.int/com.instranet.InstraServlet?command=com.instranet.CmdBlobGet&InstranetImage=593350&SecMode=1&DocId=656296&Usage=2> paragr.1 (accessed 23.12.2013).

⁸⁹ Ibid, paragr.3.

⁹⁰ Ibid, paragr.4.

⁹¹ Ibid, paragr.10.

⁹² Ibid, paragr.11.

⁹³ Ibid, paragr.16.

⁹⁴ Ligji për ekzekutimin e sanksioneve, Gazeta zyrtare e R.M nr.2/2006, neni 136, paragrafi 1, 2.

⁹⁵ Ibid, neni 137.

shoqëror. Nga kjo vjen edhe kuptimi dhe qëllimi i procesit të edukimit, si formë e tretmaneve riedukuese institucionale.

Edukimi social-etikë paraqet një veprimtari të vetëdijshme dhe planifikuese, e drejtuar kah strukturimi pozitiv i personalitetit dhe ndryshimit të saj, në kuptim të socializimit dhe pasurimit të cilësive shpirtërore, fizike, morale dhe shoqërore⁹⁶.

Edukimi është proces interaktiv, që ka për qëllim ndërtimin e qëndrimeve pozitive ndaj problemeve sociale-etike dhe vlerave shoqërore, të cilët do të shërbejnë si bazë për koordinimin e jetës shoqërore në liri⁹⁷.

Edukimi social-etikë ka për qëllim, që të ndikojë në personin e dënuar që të arrijë moralin, vlerat morale të humbura, të ndikojë në këndvështrimin negativ që ka pasur personi gjatë kryerjes së veprës penale, me një fjalë të dëpërtohet thellë në egon e personalitetit, që të zgjojë shqisat etike të mosekzistimit apo të humbjes së tyre.

3.3. Organizimi i kohës së lirë

Organizimi i kohës së lirë është pjesë përbërëse e jetës së secilit njeri. Me anë të organizimit të mirë dhe produktiv të kohës së lirë, jeta e secilit njeri do të jetë më me kuptim dhe me vlerë të madhe në mirëmbajtjen e baraspeshës së të jetuarit. Ky proces mjaft i rëndësishëm aplikohet edhe tek personat e dënuar nëpër institucionet ndëshkuese, si komponentë përbërëse në realizimin e procesit riedukues dhe risocializues. Nëse koha e lirë nuk organizohet me përmbajtje të mirë dhe të plotësuar, atëherë normalisht se për personat e dënuar, koha në institucionet ndëshkuese-korrektuese është shumë e bezdisshme dhe nuk arrin efektin e duhur, të riedukimit institucional. Personat e dënuar, kur gjenden në këtë situatë dhe nga pasojat negative që sjell izolimi, shumë lehtë bien në konfrontim si me vetveten duke sjellë çrregullime psikike, ashtu edhe me personat

⁹⁶ Sulejmanov. Z, *Penologija*, Skopje, 1999, f. 573.

⁹⁷ Milutinoviç. M, *Penologija*, Savremena administracija, Beograd, 1992, f. 125.

tjerë të dënuar në burg, por mos të harrojmë edhe me personelin e institucionit ndëshkues⁹⁸.

Çdo personi të burgosur, i cili nuk punon në hapësirë të hapur sipas kushteve kohore duhet t'i lejohej, të paktën një orë në ditë të shfrytëzojë për shëtitje, për ushtrime etj⁹⁹. Programet mirë të organizuara për edukim fizik, sport dhe aktivitete të tjera rekreative, duhet të jenë pjesë përbërëse e programit për tretman dhe për atë qëllim, duhet të sigurohet hapësirë e nevojshme, pajisje dhe instalime të ndryshme¹⁰⁰. Në institucione, doemos duhet të sigurohen kushte për organizimin dhe zhvillimin e sportit, zbavitjes dhe aktiviteteve tjera të lira, që janë me rëndësi për mirëmbajtjen e shëndetit fizik dhe mental të personave të dënuar¹⁰¹. Për realizimin e këtyre programeve të parapara sportive, rekreative dhe kulturore sigurohen hapësira të domosdoshme dhe pajisje adekuate¹⁰². Institucionet ndëshkimore-korrektuese posedojnë biblioteka personale. Përpos librave dhe shtypit ditor, personave të dënuar u mundësohet shfrytëzimi edhe i mjeteve tjera për informim dhe komunikim publik¹⁰³.

3.4. Terapia grupore psikike dhe këshillimet

Psikoterapia si formë e tretmanit të personave të dënuar, aplikohet në dy lloje: si individuale dhe si grupore¹⁰⁴. Si formë e terapisë individuale aplikohet, ndaj atyre personave që shfaqin

⁹⁸ Ibid, f. 255.

⁹⁹ Recommendation No.R (87)3 of the Committee of Ministers to Member States on the European Prison Rules (Adopted by the Committee of Ministers on 12 February 1987 at the 404 th meeting of the Ministers' Deputies). (<http://wcd.coe.int/com.instranet.InstraServlet?command=com.instranet.CmdBlobGet&InstranetImage=1977676&SecMode=1&DocId=692778&Usage=2>) paragrafi 86. (accessed 02.05.2013).

¹⁰⁰ Ibid, paragrafi 84.

¹⁰¹ Ligji për ekzekutimin e sanksioneve, Gazeta zyrtare e R.M nr.2/2006, neni 138, paragrafi 1.

¹⁰² Ibid, neni 138, paragrafi 2.

¹⁰³ Ibid, neni 139, paragrafi 1-4.

¹⁰⁴ Arnaudovski, L, *Penologija, nauka za izvršuvawe na krivi~nite sankcii*, Praven Fakultet, Skopje, 1988, f. 260.

ndryshime në jetën psikike dhe shpirtërore¹⁰⁵. Kjo formë zbatohet nga psikologët dhe psikiatërit e profesionalizuar për aplikimin e kësaj teknike metodologjike, e cila përfshinë: bindje, këshillime, sugjerime, provokime nëpërmjet kontaktit direkt me personin e dënuar, etj.¹⁰⁶.

Psikoterapia grupore paraqet mënyrën, me të cilën tentohet të zgjidhen problemet dhe konfliktet, të cilët janë të mbjellë fortë në ndërvetëdijen (ndërgjegjshmërinë) e të dënuarit¹⁰⁷. Aplikimi i psikoterapisë grupore, ka për qëllim të gjenden arsyet e sjelljes neurotike të individit nëpërmjet interpretimit të faktorëve etiologjik të psikës¹⁰⁸. Kjo metodë paraqet terapinë thelluese të bazuar në metodat e psikoanalizës së Frojdit¹⁰⁹. Psikoterapinë grupore e realizojnë psikologët, psikiatërit, punëtorët social të aftësuar për tretmanin klinik të personave të dënuar¹¹⁰.

Këshillimet paraqesin metoda të pastra grupore, të cilët shfrytëzohen me sukses për punë në grupe, në mjedise dhe kushte të ndryshme dhe për atë preferohet edhe për punë me personat e dënuar¹¹¹. Këshillimet grupore aplikohen ndaj atyre personave të dënuar tek të cilët nuk posedojnë çrregullime më të rënda emocionale, tek të cilët konfliktet e jashtme nuk janë të karakterit neurotik, por të karakterit adaptiv (përshtatës)¹¹².

¹⁰⁵ Ibid, f. 261.

¹⁰⁶ Ibid, f. 261.

¹⁰⁷ Krlev. T, *Zatvor*, NIO Studentski zbor, Skopje, 2001, f. 273.

¹⁰⁸ Ibid, f. 273.

¹⁰⁹ Ibid, f. 273.

¹¹⁰ Fenton. N, *Le Grup Connselting in Theorie of en Practiqua*, Fondation Internationale Penale et Penitentiare, Bruxelles, 1962, f. 8-9 cit.sipas Arnaudovski. L, *Penologija, nauka za izvršuvawe na krivi~nite sankcii*, Praven Fakultet, Skopje, 1988, f. 261,262.

¹¹¹Arnaudovski. L, *Penologija, nauka za izvršuvawe na krivi~nite sankcii*, Praven Fakultet, Skopje, 1988, f. 262.

¹¹² Krlev. T, *Zatvor*, NIO Studentski zbor, Skopje, 2001, f. 272.

3.5. Shpërblimet dhe dënimet

Shpërblimet janë metoda apo forma motivuese dhe stimuluese për personat, që tregojnë rezultate të mira në aktivitetet e përditshme penitenciare drejt risocializimit të tyre, kurse dënimet më shumë rezultojnë si forma represive ndaj atyre që nuk iu përmbahen rregullave, apo janë në kundërshtim me organizimin e brendshëm të sistemit penitenciar¹¹³.

Shpërblimet dhe dënimet duhet të jenë të harmonizuara ndërmjet veti, të përdorura në kohë, në moment të duhur dhe gjithnjë në suaza të përshtatshmërisë me vlerat e njeriut dhe me procesin e arritjes së risocializimit¹¹⁴.

Personat e dënuar në institucionet korrektuese-ndëshkuese, për shkak sjelljeve të mira, fitojnë disa beneficione. Si beneficione më të përdorura llogariten: zgjerimi i së drejtës për pranimin e vizitave, zgjerimi i së drejtës për pranimin e pakove, zgjerimi i së drejtës për pranimin dhe këmbimin e letrave, vizita pa mbikëqyrje nga personeli i institucionit, vizita familjare jashtë institucionit, shfrytëzimi i pushimit vjetor në shtëpi, mundësimi i vazhdimit të studimeve dhe shkollimit me korrespondencë jashtë institucionit, rregullimi i hapësirës për të jetuar me sendet personale dhe pranimi më i shpeshtë i dërgesave dhe pranimi i dërgesave me peshë më të madhe, kontaktet më të shpeshta me botën e jashtme, vizita të vazhduara apo vizita pa mbikëqyrje në hapësirat e institucionit, qëndrimi me bashkëshortin martesor apo jashtëmartesor në hapësirë të veçantë pa mbikëqyrje, dalje e lirë jashtë institucionit deri më 7 orë, mungesë deri më 15 ditë gjatë vitit, me çka mungesa gjatë muajit nuk mund të jetë më e gjatë se 3 ditë, shfrytëzimi i tërësishëm apo i pjesërishtëm i pushimit jashtë nga institucioni si dhe beneficione tjera¹¹⁵.

¹¹³ Arnaudovski. L, *Penologija, nauka za izvršuvawe na krivi~nite sankcii*, Praven Fakultet, Skopje, 1988, f. 264.

¹¹⁴ Ibid, f. 264.

¹¹⁵ Osmani. A, *Komentari i ligjit për ekzekutimin e sanksioneve*, Shkup, 2013, f. 171,174.

Dënimet i hasim qysh në kohët e vjetra, që nga atëherë kur qëllimi i dënimit ishte vuajtja, shpagimi. Mirëpo, në sistemet penitenciare bashkëkohore në vendet e ndryshme të botës, dënimet i distancohen qëllimeve retributive, torturuese dhe hakmarrëse dhe kanë për qëllim, çdoherë arritjen e vlerave njerëzore dhe përdorimi i tyre, tanimë shkon drejt realizimit të procesit të risocializimit¹¹⁶.

Për shkeljen e rendit dhe disiplinës ndaj personave të dënuar mund të zbatohen këto dënime disiplinore: vërejtje, vërejtje publike, marrjen e një pjese të kompensimit për punë në lartësi prej 20%, kufizimi i ndarjeve të shpërblimeve deri tre muaj nëse i dënuari i ka keqpërdorur lehtësimet e dhëna dhe dërgimi në qeli prej 3 deri 15 ditë me ose pa të drejtë të punës¹¹⁷.

KONKLUZIONE

- Tretmani i personave të dënuar paraqitet si një konglomerat kompleks i metodave, mënyrave, procedurave të organizuara të veprimit me personin e dënuar para, gjatë vuajtjes së dënimit dhe pas daljes nga institucionet ndëshkuese me qëllim të adaptimit sa më të plotë dhe funksional me vlerat që i ofron shoqëria.

- Me anë të përdorimit të mirë, të koordinuar dhe të sistemuar të metodave të tretmanit do të kemi risocializim, riadaptim dhe riintegrim më të suksesshëm të personave të dënuar.

- Harmonizimi i dispozitave të legjislacionit vendas me ato ndërkombëtare është kusht për përdorimin e drejtë dhe të suksesshëm të tretmanit nëpër institucionet penitenciare vendase.

- Rëndësi të veçantë në riedukimin, risocializimin dhe adaptimin social kanë format e tretmanit të personave të dënuar.

- Puna paraqet faktorin primar për edukimin dhe riedukimin e personave të burgosur.

¹¹⁶ Arnaudovski. L, *Penologija, nauka za izvršuvawe na krivi~nite sankcii*, Praven Fakultet, Skopje, 1988, f. 264.

¹¹⁷ Ligji për ekzekutimin e sanksioneve, Gazeta zyrtare e R.M nr.2/2006, neni 178, paragrafi 1-5.

CONCLUSIONS

- Treatment of convicted people appears as a complex conglomerate of methods, approaches, organized procedures of action by the convicted person, during detention and after release from the penitentiary for so much complete and functional adaptation with values that the society offers.

- Through the use of well coordinated and systematic methods of treatment we will have socialization, re-adaptation and more successful reintegration of convicted persons.

- The harmonization of national legislation with the provisions of international ones is a condition provided for the fair and successful use of local treatment in penitentiary institutions.

- Paramount importance in rehabilitation, socialization and social adaptation have forms of treatment of convicted persons

- The work represents the primary factor for the education and rehabilitation of prisoners.

BIBLIOGRAFIA

1. Arnaudovski, Lup~o, *Penologija, nauka za izvr{uvawe na krivi~nite sankcii*, Praven Fakultet, Skopje, 1988.

2. Halili, Ragip, *Penologija,shkenca mbi ekzekutimin e sanksioneve penale*, Prishtinë, 2005

3. KraleV, Todor, *Zatvor*, NIO Studentski zbor, Skopje, 2001.

4. Milutinovi~c, Milan, *Penologija*, Savremena administracija, Beograd, 1992.

5. Osmani, Afrim, *Komentari i ligjit për ekzekutimin e sanksioneve*, Shkup, 2013.

6. Sulejmanov, Zoran, *Penologija*,Skopje, 1999.

Aktet normative:

7. Recommendation No.R (87)3 of the Committe of Ministers to Member States on the European Prison Rules (Adopted by the Committee of Ministers on 12 February 1987 at the 404 th meeting of the Ministers' Deputies).

(<http://wcd.coe.int/com.instranet.InstraServlet?command=com.instranet.CmdBlobGet&InstranetImage=1977676&SecMode=1&DocId=692778&Usage=2>) (accessed 02.05.2013)

8. Recommendation No.R(89)12 of the Committee of Ministers member states on education in prison (Adopted by the Committee of Ministers on 13 October 1989 at the 429 th meeting of the Ministers' Deputies).

(<https://wcd.coe.int/com.instranet.InstraServlet?command=com.instranet.CmdBlobGet&InstranetImage=593350&SecMode=1&DocId=656296&Usage=2>) (accessed 23.12.2013)

9. Ligji për ekzekutimin e sanksioneve, Gaz.Zyrtare e R.M, nr. 2/2006, 57/2010.

10. Udhëzim për llojet dhe mënyrën e tretmanit të personave të dënuar (Gaz.Zyrtare e R.M-së nr.123/2007).